Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1000

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Batisha Ibrahimi Anëtare dhe Isa Hasani Anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Infosoft Systems SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Krijimi i Qendrës së Rimëkëmbjes" me numër të prokurimit 214-24-6184-1-1-1, me 30.12.2024 mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjeserisht e bazuar ankesa e OE Infosoft Systems SH.P.K. me nr. 2024/1000 , e datës 17.10.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Krijimi i Qendrës së Rimëkëmbjes" me numër të prokurimit 214-24-6184-1-1-1 inicuar nga Autoriteti Kontraktues "MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME "

2. Mbetet në fuqi vendimi i AK sipas pikes I të këtij dispozitivi.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Infosoft Systems SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 24.06.2024 Ministria e Punëve të Brendshme., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Krijimi i Qendrës së Rimëkëmbjes" me numër të prokurimit 214-24-6184-1-1-1.

Me 24.09.2024, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimi mbi vendimin (B58) ku ka shpërblyer me kontratë OE Virtuo O.P.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës furnizim me vlerë të kontratës 2,145,297.00 euro.

Me 27.09.2024OE Infosoft Systems SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Ku Autoriteti Kontraktues me 07.10.2024 e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 17.10.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Infosoft Systems SH.P.K., me numër protokolli 2024/1000 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Krijimi i Qendrës së Rimëkëmbjes" me numër të prokurimit 214-24-6184-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Infosoft Systems SH.P.K., janë parashtruar si në vijim: "*Përgjegjshmëria e ofertës sonë: • Dokumentacioni ynë plotëson të gjitha kërkesat teknike dhe profesionale të përshkruara në Dosjen e Tenderit (FDT). • Refuzimi i ofertës sonë nga AK është i pabazuar dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP). • AK nuk ka trajtuar dokumentet tona në mënyrë profesionale dhe ka refuzuar pa kërkuar sqarime shtesë, siç lejon LPP. • Argumentet tona mbështeten me dëshmi të qarta, si: çertifikata, kontrata pune, referenca dhe CV për ekspertët e përfshirë. • AK ka interpretuar gabimisht kërkesat e tenderit, veçanërisht lidhur me kërkesat teknike për "Load Balancer" dhe platformat serverike. Papërgjegjshmëria e ofertës së OE të shpërblyer: • Dokumentacioni i OE të shpërblyer është i paplotë dhe nuk përputhet me specifikimet e kërkuara në FDT. • Produktet e ofertuara nuk i përmbushin kërkesat minimale teknike, si në rastin e disqeve NVMe, ku produkti i propozuar (Lenovo ThinkAgile VX650 V3) nuk mbështet NVMe Gen5, siç kërkohej në tender. • Shkelje të tjera teknike dhe administrative janë të dokumentuara dhe të lehtësisht të verifikueshme në dokumentacionin e OE të shpërblyer. Shkelje të legjislacionit të prokurimit nga AK: • AK ka injoruar rregullat bazë të prokurimit, duke mos kërkuar sqarime shtesë për dokumentet tona, siç përcakton LPP. • Vendimi i AK-së është në kundërshtim me rregulloret dhe udhëzuesit e prokurimit publik (Rregullorja 001-2022 dhe Udhëzuesi Nr. 001-2023). • AK ka favorizuar OE-në e shpërblyer duke mos analizuar siç duhet papërgjegjshmërinë e ofertës së tij. Kërkesa: Kërkojmë që OSHP të rishikojë në detaje ofertën tonë dhe të konsiderojë përgjegjshmërinë e saj, si dhe të konstatojë papërgjegjshmërinë e ofertës së OE të shpërblyer, duke anuluar vendimin e AK-së dhe duke nxjerrë një vendim të drejtë e meritor."*

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: "*Ministria e Punëve të Brendshme - ZPP, pas pranimit të Kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore, të tenderuesit Infosoft Systems shpk Prishtinë. Pas analizës së pretendimeve të cekura në Kërkesën për rishqyrtim, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të publikuar me datën 24.09.2024,*

konstaton se aktiviteti i prokurimit për këtë fushë është publikuar në harmoni të plotë me LPP-në dhe nenet: (Neni 7, Neni 59, Neni 69, Neni 72 dhe me nenët në vijim të Rregullorës 001-2022 për Prokurim Publik: Neni 38; Neni 40; Neni 45). AK-MPB ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë tenderuesit pjesëmarrës, edhe juve në këtë AP, në harmoni të plotë me LPP-në dhe aktet tjera dytësore mbi prokurimin publik të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 7) Pretendimi i tenderuesit ankues Infosoft Systems shpk Prishtinë, se AK me rastin e vlerësimit të tenderëve ka shkelur Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) është i pabazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionit të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm me çmim më të lirë.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes, është refuzuar për arsye se nuk keni dorëzuar dëshmi të vlefshme dhe të mjaftueshme, siç është kërkuar në Dosjen e tenderit - SEKSIONI II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 dhe 9.2 për të cilat jeni njoftuar me B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar). Autoriteti Kontraktues, me rastin e shpalljes së Tenderuesit Virtuo O.P., Prishtinë, fitues për këtë kontratë, nuk ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, nuk ka bërë kurrfarë favorizimi të ofertës së tij, i cili sipas vlerësimit nga ana e AK është i përgjegjshëm, andaj në këtë rast nuk kemi të bëjmë me diskriminimin e tenderuesit ankues.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 59 i LPP-së):"Pretendimi i tenderuesit ankues Infosoft Systems shpk Prishtinë, thotë se AK me rastin e vlerësimit të tenderëve ka shkelur Nenin 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Ky pretendim i cekur më lartë nga tenderuesi ankues, nuk qëndron, sepse Autoriteti Kontraktues, pasi ka shqyrtuar me kujdes kërkesën për rishqyrtim, konstaton edhe njëherë se nuk qëndrojnë pretendimet e cekura, sepse Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit u ka përmbajtur dhe zbatuar nenin 59 par. 4 të LPP-së, citojmë: "Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes, është i papërgjegjshëm dhe është refuzuar, sepse nuk keni dorëzuar dëshmi të vlefshme dhe të mjaftueshme, siç është kërkuar në pajtueshmëri me Nenin 69 të LPP-së, njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, për kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2. Arsyetimet për eliminimin janë cekur në Letërn standarde për tenderuesin e eliminuar, si vijon:Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju kemi njoftuar se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:Tenderi juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenin 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat e kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 21.10.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe me datë 24.10.2024 ekspertin teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/1000, ndërsa me datë 13.11.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1000, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërishte bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në

rivlerësim.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet e parashtruara nga OE ankues : "*AK me datë 24.09.2024, ka publikuar njoftimin mbi vendimin AK-së përkatësisht letrat standarde për tenderuesit në këtë aktivitet, ku për OE ka dërguar letrën standarde për tenderuesin e eliminuar duke specifikuar arsyen e eliminimit si vijon: " Tenderi juaj është refuzuar per këto arsye, sepse gjate procedurës se ekzaminimit, vieresimit dhe krahasimit le tenderit Tuaj, komisioni i veresimit ka konstatuar se nuk keni dorezuar deshmi tö vlefshme dhe te njaftueshme, si eshte kerkuar ne Dosjen e tenderit - SEKSIONT II. FI ETA R TÍ: DHENAVETE TENDERIT (FTD) (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 dhe 9.2. për pikat ne vijim: Kërkesa 5. Operator ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, dunet te disponoj me së paku ife ekspert per platformal serverike te ofruar i cili duhet te kene pervojé pune minimumi 3 vite, te kene te pakten 1 projekt te realizuar oga fusha e tarte cekur Deshmia e karkuar dokumentare: 5. a. Certifikate perkatese, (kopje e noterizuar nga originali ose linkun per verifikim): b. Kontraté ose marroveshja e punes valide me punedhenésin per kete projekt (kopie): Leter reference nga punedhenesit ose cfaredo dokumenti tjeter de deshmon pervojen e Leter reference nga punedhenesit ose cfareda dokumenti tjeter ge deshmon pervojen ne projektet e realizuara - (kopje); e. CV-ne 1. Per piken 914- pür poziten nje ckspert te certifikuar nga prodiuesi per Load balancer zgjidhjen, e keni prezantuar 1 zyrtar@ (A.A.), i cili eshté i pa pergiegishem, sepse per te nfkitin i keni bashkangjitur referencat te cilat nuk e plotesujne kerkesön te pakten 1 projekt te realizuar nga fusha e larte cekur (ekspert te certifikuar nga prodhuesi per Load balancer zgjidhjen) 2. Pör piken 91.5. per poziten uje elspert pür platformat serverike te olruar, e keni prezantuar 1 zyrtare (A.L.), 1 cili öshte i pa pergiegishem sepse per te njejtin i keni bashkangjitur referencat te eilat nuk i plotesujne kerkesat te kene le pakten 1 projekt te natyres sü ngjashme (ekspert per platformat serverike te ofruar). Letér referenca e dates 14 08.2024 e dorezuar pérfshin projekte te cilat jané realizuar sherbing dhe nuk ka asnjë projekt to natyrës se ngjashme, prandaj për arsyet e cekura me larte tenderi Juaj shte refuzuar dhe nuk kalon ne vlerësimin e mëtutjeshëm."*

Lidhur me pretendimin e parë ankimor :"*OE ankues pretendon se nuk qëndron arsyeja e eliminimit lidhur me kërkesën numër 4 të kapacitetit teknik dhe profesional. Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 1AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Seksionin I1 – Fleta e të Dhënave të Tenderit, ka vendosur kërkesën si vijon: "4. Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të disponoj me së paku një ekspert të certifikuar nga prodhuesi për Load balancer zgjidhjen, i cili duhet të kenë përvojë pune minimumi 3 vite, të kenë të paktën 1 projekt te realizuar nga fusha e lartë cekur." Lidhur me këtë kërkesë është kërkuar nga ofertuesit të dorëzojnë dëshmitë si vijon: "1.a.Certifikate përkatëse, (kopje e noterizuar nga origjinali ose linkun për verifikim); b.Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c.Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(kopje);d.Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara – (kopje); e.CV-në."OE ankues në tenderin e tij lidhur me këtë kërkesë ka dorëzuar dëshmitë si vijon:Listën e stafit e nënshkruar dhe vulosur, në të cilën evidentohet se Ekspert i certifikuar për load balancer është z.Aleksander Arsovski.CV e z. Alexander Arsovski ku paraqiten informatat, për shkollimin përvojën e punës, trajnimet, certifikimet dhe shkathtësitë. Në njërën nga përvojat (tek kompania Kernel) tek detyrat dhe*

përgjegjësitë prezantohet informacioni ku ndër të tjera thuhet: "Management of the implementation of Fortinet products (FortiMail, FortiGate, FortiWeb, FortiAnalyzer, FortiAdc)Certifikaten e lëshuar nga Fortinet me datë 16 shtator 2022 për Fortinet NSE 6 – FortiADC.Referencën e lëshuar nga NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi – Shkup Republika e Maqedonisë.Referencën e lëshuar nga Kernel Group, në të cilën shënohet "Konfirmojmë se Aleksandar Arsovski është i punësuar në kompani që nga data 07.08.2021 dhe ka kryer me sukses detyrën si specialist për instalime, konfigurime dhe integrim të pajisjeve të TI-së, në projektet e mëposhtme:Klienit: Ujësjellësi dhe Kanalizimi, emri i projektit "Network security analysis system", pozita Inxhinier në projekt.Klienit: Ministria e Punëve të jashtme, emri i projektit "Mirëmbajtja e pajisjeve të informacionit", pozita Inxhinier në projekt.Klienit: Ministria e Punëve të jashtme, emri i projektit "Mirëmbajtja dhe instalimi i pajisjes së rrjetit", pozita Inxhinier në projekt.AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, "Meqenëse ne këto referenca për keta ekspert nuk janë cekur se janë nga fusha e lartcekur e kërkuar, AK nuk ka patur nevoje bazuar ne nenin 59 dhe 72 te LPP-se, te kërkojmë qe te siguroni sqarimin e tenderit tuaj."Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 1 Lidhur me këtë pretendim eksperti me qëllim të shtjellimit të detajuar për Panelin Shqyrtues sqaron se "Load balancimi" në IT është një proces që shpërndan ngarkesën e punës ose trafikun nëpër disa servera për të përmirësuar performancën, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e një sistemi. Pra, nuk është fushë por një proces në infrastrukturën e TI-së, që und të implementohet përmes pajisjes fizike ose si softuerëve. Për AK në këtë pikë nuk është kontestuese kompetenca e dëshmuar përmes certifikimit por përvoja (sikurse është kërkuar: të kenë të paktën 1 projekt te realizuar nga fusha e lartë cekur). Bazuar në dëshmitë e dorëzuara në tenderin e OE ankues, përkatësisht në CV e z.Aleksander Arsovski evidentohet se i njëjti në përshkrimin e punëve, ndër të tjera ka përvojë në menaxhimin e zbatimit të produkteve të Fortinet (FortiMail, FortiGate, FortiWeb, FortiAnalyzer, FortiAdc). Rrjedhimisht ekziston informacioni se i njëjti ka përvojë në "Load Balacing" si zgjidhje e përmendur tek FortiAdc dhe sipas përcaktimit të AK-së dëshmia mund të jetë referencë ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën.

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor *:"OE ankues pretendon se nuk qëndron arsyeja e eliminimit lidhur ekspertin për platformat serverike të ofruar Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 2AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Fletën e të Dhënave të Tenderit, ka vendosur kërkesën si vijon: "5. Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të disponoj me së paku një ekspert për platformat serverike të ofruar, i cili duhet të kenë përvojë pune minimumi 3 vite, të kenë të paktën 1 projekt te realizuar nga fusha e lartë cekur." Lidhur me këtë kërkesë është kërkuar nga ofertuesit të dorëzojnë dëshmitë si vijon: "5.a.Certifikate përkatëse, (kopje e noterizuar nga origjinali ose linkun për verifikim); b. Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(kopje); d. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara – (kopje); e.CV-në."OE ankues lidhur me këtë kërkesë ka dorëzuar dëshmitë:Listën e stafit e nënshkruar dhe vulosur, në të cilën evidentohet se Ekspert i certifikuar për platformat serverike është z.Aleksandri Loçi.CV e z.Aleksandri Loçi ku paraqiten informatat, për shkollimin përvojën e punës, trajnimet, certifikimet dhe shkathtësitë. Në njërën nga përvojat (tek kompania Infosoft Systems) tek përshkrimi i detyrave prezantohet informacioni ku ndër të tjera thuhet: "Menaxhimi dhe monitorimi i të gjithë sistemeve dhe infrastrukturës së instaluar. - Instalimi, konfigurimi, testimi dhe mirëmbajtja e sistemeve operative, programet e aplikimit dhe mjetet e menaxhimit të sistemit.- Sigurimi i niveleve më të larta të sistemeve dhe disponueshmërisë së infrastrukturës."Certifikatën e lëshuar nga HPE në të cilën shënohet se Aleksandri Loci ka fituar titullin HPE Accredited Technical Profesional Server Solution V4.Certifikatën e lëshuar nga*

HPE në të cilën shënohet se Aleksandri Loci ka fituar titullin HPE Accredited Solution Expert Edge-to-Cloud Architect.Referencë e lëshuar nga Infosoft Systems për Z. Aleksandri Loçi, që konfirmon se ai është i punësuar në kompani që nga 17.06.2019 dhe ka punuar si specialist për instalime, konfigurime, dhe integrime të pajisjeve të TI në projekte të ndryshme. Ai ka shërbyer si inxhinier i çertifikuar për server në projektet kryesore të vitit 2023, përfshirë mirëmbajtjen e sistemit të thesarit për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përmirësimin e sistemit e-dpshtrr për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, dhe mirëmbajtjen e sistemit e-receta për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Ai ka përvojë edhe në projekte të mëparshme, si mirëmbajtja e bazës së të dhënave të centralizuar të Portabilitetit të Numrit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare në vitin 2021.AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, "Meqenëse ne këto referenca për këta ekspert nuk janë cekur se janë nga fusha e lartcekur e kërkuar, AK nuk ka patur nevoje bazuar ne nenin 59 dhe 72 te LPP-se, te kërkojmë qe te siguroni sqarimin e tenderit tuaj."Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 2 -Lidhur me këtë pretendimi eksperti sqaron se kërkesa e AK-së është që OE të këtë i cili duhet të kenë përvojë pune minimumi 3 vite, të kenë të paktën 1 projekt te realizuar nga fusha e lartë cekur, e cila dëshmohet sipas formulimit të AK-së me letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara – (kopje). OE ankues krahas dëshmive tjera ka dorëzuar CV-në dhe referencën në të cilën prezantohen projektet e realizuara. Rrjedhimisht ekziston informacioni se i njëjti ka përvojë në platformat serverike, dhe nëse për AK-në informacioni i prezantuar nuk është bindës do të duhej të kërkonte sqarimin e tenderit konform dispozitave të LPP-së. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

B. Pretendimet për tenderin e OE të rekomanduar për kontratë

Lidhur me pretendimin e tretë ankimor : "*OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson specifikimet teknike për disqet të përcaktuara në dosjen e tenderit në pozicionin 1.Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 3AK në dosjen e tenderit, përkatësisht tek Aneksi 1-Specifikimet Teknike të Detyrueshme, pika 3.3 Kërkesat teknike, pozicioni 1, ndër të tjera ka përcaktuar specifikimin teknik si vijon: " The HCI should be proposed with 7.6TB NVMe for capacity tier per server node, with min 50TB per Node with min 7.68 NVMe Gen 5 per node. Appropriate RAID Controller must be supplied with Caching capabilities."AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka përcaktuar kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional si vijon: "7. Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të sjellin katalogët ose broshura prej prodhuesit për pajisjet që oferton. Katalogët ose broshurat, duhet të jenë të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike për secilin lloje te pajisjes qe oferton. Nëse katalogu përfshin më shumë modele, ju duhet të nënvizoni (shënjoni) modelin me të cilin ofertoni;" Lidhur me këtë kërkesë, AK ka përcaktuar që OE-të duhet të dorëzojnë dëshmitë si vijon: "7. Katalogë ose broshura (kopje)."OE i rekomanduar për kontratë lidhur me këtë pozicion ka dorëzuar broshurën e prodhuesit Lenovo për serinë e produktit ThinkAgile VX Series, ku ka rrethuar modelin e ofertuar VX650 V3.Në broshurën e prodhuesit nuk janë paraqitur të specifikimet teknike të detajuara në raport me specifikimet teknike të kërkuara në dosjen e tenderit. Respektivisht në broshurën zyrtare të prodhuesit nuk specifikohet modelet/llojet e disqeve që ofertohen.OE i rekomanduar ka dorëzuar deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara, ku evidentohet se OE ka ofertuar me produktin Lenovo ThinkAgile VX650 V3 Certified Node (part number 7D6WCTO2WW). Në përshkrim, shënohet si pjesë që ofertohet është ThinkSystem 2.5" U.2 CD8P 7.68TB Read Intensive NVMe PCIe 5.0 x4 HS SSD (Feature code C0B9).Në pretendimin ankimor, OE ankues ka bashkangjitur broshurën e prodhuesit Lenovo si dhe linkun e prodhuesit për konfigurimin e pajisjes me*

komponentët përkatëse, në të cilat nuk figuron modeli i diskut C0B9 i përmendur në deklaratën e OE.Në vendimin e AK-së për refuzim e kërkesës për rishqyrtim, lidhur me këtë pretendim ankimor ka dhënë arsyetimin si vijon: " Ky pretendim është i pabazuar. Linku nga prodhuesi Vmware ku ceket qe Lenovo ThinkAgile VX series është i certifikuar për VSAN dhe ka PCie Gen5: https://core.vmware.com/resource/vmware-horizon-8-vmware-vsan-express-storage-architecturelenovo-thinkagile-vx-series#executive-summary"Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 3- Eksperti sqaron se kërkesa e AK-së ishte që OE të dorëzojnë katalog ose broshura prej prodhuesit për pajisjet që oferton, të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike. Në këtë rast OE ka dorëzuar broshurën ku evidentohet produkti (pajisja) Server Lenovo ThinkAgile VX650 V3 Certified Node (part number 7D6WCTO2WW), por në të cilën nuk është dhënë informacioni për disqet që përkrahen. OE i rekomanduar ka dorëzuar vetëm në deklaratën e tij informatat e diskut që oferton të shoqëruar. Në anën tjetër OE ankues ka dorëzuar dëshmitë e prodhuesit (broshurën e detajuar dhe konfiguratorin) e pajisjes Lenovo ThinkAgile VX650 V3 Certified Node në të cilën nuk paraqitet opsioni i diskut NVMe PCIe 5.0 x4 SSD. Eksperti ka verifikuar në konfiguratorin zyrtar të pajisjes sikurse në linkun në vijim: https://dcsc.lenovo.com/#/configuration/cto/7D6WCTO2WW, dhe nuk ka informacion për opsionin e diskut ThinkSystem 2.5" U.2 CD8P 7.68TB Read Intensive NVMe PCIe 5.0 x4 HS SSD (Feature code C0B9). Për me shumë në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim tek ky pretendim, AK është arsyetuar mbi bazën e VMware (një link) në të cilin nuk ka informacion se modeli i këtij serveri përkrah apo ka opsionin e diskut të ofertuar nga OE i rekomanduar. Argumenti i përdorur nga AK përveç që nuk është i qëndrueshëm, nuk është as konform kërkesës së dosjes së tenderit ku një gjë e tillë kërkohet të dëshmohet nga broshura e prodhuesit. Në këtë mënyrë, me dëshmitë e prezantuar në procedurë nuk mund të konstatohet se plotësohen specifikimet teknike të dosjes së tenderit. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar. Rrjedhimisht Eksperti i rekomandon Panelit Shqyrtues që të obligojë AK-në të kërkojë sqarime shtesë -broshurën e detajuar të pajisjes Server Lenovo ThinkAgile VX650 V3 Certified Node (part number 7D6WCTO2WW), apo konfirmimin zyrtar nga prodhuesi se a i përkrah Lenovo ThinkAgile VX650 V3 Certified Node disqet PCIe 5.0 NVMe SSD, përkatësisht diskun e ofertuar (Feature code C0B9), në mënyrë që të vlerësohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin e katert ankimor: "*OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson specifikimet teknike përkatësisht licencat për "Disaster Recovery".Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 4Në dosjen e tenderit, përkatësisht Aneksin 1 të dosjes së tenderit, tek pozicioni 1, AK ndër të tjera ka përcaktuar specifikimin si vijon: "The HCI solution must provide the following Disaster Recovery features and all licenses should be included from day 1. The HCI solution should have feature failback process to Primary data center, also must provide the ability to perform DR tests.Replication Solution should be able to Replicate to Traditional/Converge Infrastructure as well if required." Poashtu, AK në dokumentin e sqarimeve shtesë të dosjes së tenderit, të publikuar me datë 10.07.2024 ("3. Informacione Sqaruese Shtesë të DT", Sqarimi nr. 1), ka sqaruar se licencat për "Disaster Recovery" duhet të mbulojnë të paktën 300 makina virtuale.OE i rekomanduar ka dorëzuar broshurën e për produktin(shërbimin) VMware Cloud Foundation.Në vendimin e AK-së për refuzim e kërkesës për rishqyrtim, lidhur me këtë pretendim ankimor ka dhënë arsyetimin si vijon: " Ky pretendim është i pabazuar. Kërkesa ka qenë për disaster recovery te cilën VMware Cloud Foundation vjen me licencen HCX enterprise e cila ben replikimin e pjeses primare ne ate secondare dhe anasjeltas dhe me kete behet disaster recovery ne te gjitha nivelet dhe nuk ka kufizime ne numrin e VM dhe eshte e licencuar per core ne kuader te VCF licencave. Me poshte si prove eshte linku https://www.vmware.com/docs/vmw-hcx-application-migration-and-mobility-platform.*

Business continuity and disaster protection Leverage the VMware HCX hybrid interconnect and rapid migration capabilities to protect workloads by replicating data across common VMware infrastructure in two or more places. Back up critical workloads on demand, or schedule for disaster recovery planning seamlessly and securely with no reconfiguration of IPs. VMware HCX now integrates with VMware Site Recovery Manager™ for advanced use cases Vmware HCX përmbushë kërkesën e disaster recovey siç është kërkuar dhe tejkalon numrin e vm prej 300 dhe është pa limit derisa kemi licenca per core."Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 4-AK në dosjen e tenderit, krahas specifikimit teknik minimal, tek hyrja e specifikimeve teknike ndër të tjera thekson: "....Pra, është e rëndësishme nevoja që ta kemi edhe një infrastrukturë tjetër në një lokacion tjetër për shfrytëzim si qendër e rimëkëmbjes në rast të fatkeqësive të ndryshme qoftë nga korruptimi i të dhënave, hakimi , vjedhja apo fshirja aksidentale, po ashtu nga dështimi i infrastrukturës jo IT si mungesa e energjisë, dëmtimi nga uji apo edhe tërmetet, etj.". Broshura e dorëzuar nga OE përmban informata për pakon VMware Cloud Foundation si dhe shtojcat që janë evidentuar në fund të broshurës. Duke marrë për bazë formulimin e tërësishëm të projektit në aneksin 1, ku përmenden te dy termet, edhe migrim edhe integrim, eksperti rekomandon Panelin Shqyrtues që të obligoj AK-në të kërkojë sqarime shtesë - broshurën e detajuar të shërbimit të ofertuar apo konfirmim nga prodhuesi Lenovo dhe/apo VMware për te qartësuar nëse pakoja e ofertuar (VMware Cloud Foundation) përmbush nevojat për këtë aktivitet të prokurimit, apo janë të nevojshme shtojcat të cilat kanë kosto shtesë. Rrjedhimisht, Eksperti i propozon Panelit Shqyrtues qe ky pretendim te aprovohet si pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e pestë ankimor: "*OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson specifikimet teknike përkatësisht shërbimi i mbështetjes i ofruar për HCI nodes.Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 5Në dosjen e tenderit, përkatësisht Aneksin 1 të dosjes së tenderit, tek pozicioni 1, AK ndër të tjera ka përcaktuar specifikimin si vijon: "3 years Direct Vendor Support with 24X7x365 coverage and access to vendor support. (shqip: 3 vjet mbështetje e drejtpërdrejtë e shitësit me mbulim 24X7x365 dhe qasje në mbështetjen e shitësit)" OE i rekomanduar për kontratë lidhur me këtë pozicion ka dorëzuar broshurën e prodhuesit Lenovo për serinë e produktit ThinkAgile VX Series, ku ka rrethuar modelin e ofertuar VX650 V3.Në broshurën e prodhuesit: shënohet informacioni: "Sistemet e integruara të serisë Lenovo ThinkAgile VX mund të konfigurohen me një garanci harduerike tre ose pesëvjeçare me një pikë mbështetjeje 24x7". OE i rekomanduar ka dorëzuar deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara, ku evidentohet se OE ka ofertuar shërbimin "Foundation ThinkAgile CN - 3Yr NBD Resp VX650 V3" me features code "5WS7B14828".Lidhur me këtë pretendim, AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ka dhënë arsyetimin si vijon: "Ky pretendim është i pabazuar. Bazuar në linkun e prodhuesi me poshtë, ku thuhet: The VX630 V3 Integrated Systems comes paired with Premier Support that offers a single point of support for quick 24/7 problem reporting and resolution. Pra kemi të bëjmë me PREMIER FOUNDATION THINK AGILE CN -3YR NBD e cila është 24/7/365. Nëse e shikon screenshot e deklaratës së OE Virtuo qe vet e keni dorëzu në ankesë shkruan: Lenovo Xclarity Platinium Upgrade e cila është upgrade i support-it."Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 5-Lidhur me këtë pikë, sipas dëshmive të dorëzuara, përkatësisht në deklaratën e dorëzuar nga OE i rekomanduar lidhur me mbështetjen e Nodes HCI platform, është ofertuar shërbimi Foundation ThinkAgile CN - 3Yr NBD Resp VX650 V3 (Features code: 5WS7B14828). Ky element (specifikim i shërbimit) nuk është shoqëruar me katalog apo informatë nga prodhuesi. Në anën tjetër, në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK i është referuar një modeli tjetër (VX630 V3 IS) për të argumentuar se OE i rekomanduar plotëson kërkesën lidhur me mbështetjen nga prodhuesi. Eksperti i*

rekomandon Panelit Shqyrtues që të obligojë AK-në të kërkojë sqarime shtesë -broshurën e detajuar të shërbimit të mbështetjes, apo informatë zyrtar nga prodhuesi se çka përfshinë shërbimi i ofertuar Foundation ThinkAgile CN - 3Yr NBD Resp VX650 V3 (Features code: 5WS7B14828), në mënyrë që të vlerësohet pajtueshmëria me kërkesat e dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin e gjashtë ankimor: "*OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson specifikimet teknike përkatësisht shërbimi i mbështetjes për Vmware.Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 6Në dosjen e tenderit, përkatësisht Aneksin 1 të dosjes së tenderit, tek pozicioni 1, AK ndër të tjera ka përcaktuar specifikimin si vijon: "3 years Direct Vendor Support with 24X7x365 coverage and access to vendor support, into all possible updates, patches and upgrades covering the HCI solution.".OE i rekomanduar për kontratë lidhur me këtë pozicion ka dorëzuar broshurën e prodhuesit Lenovo për serinë e produktit ThinkAgile VX Series, ku ka rrethuar modelin e ofertuar VX650 V3. Në broshurën e prodhuesit: shënohet informacioni: "Sistemet e integruara të serisë Lenovo ThinkAgile VX mund të konfigurohen me një garanci harduerike tre ose pesëvjeçare me një pikë mbështetjeje 24x7 (hardueri i serverit Lenovo dhe softueri VMware nga Broadcom; kërkon një kontratë mbështetëse aktive të softuerit të blerë nga Lenovo).Në vendimin e AK-së për refuzim e kërkesës për rishqyrtim, lidhur me këtë pretendim ankimor ka dhënë arsyetimin si vijon: "Ky pretendim është i pabazuar. Kerkesa ka qene: 3 years Direct Vendor Support with 24X7x365 coverage and access to vendor support, into all possible updates, patches and upgrades covering the HCI solution. Kjo do te thote direct support nga ana e HCI dhe jo nga Vmware. Ne kete rast kemi te bëjmë me Lenovo si HCI soluton dhe ky sherbim eshte direkt nga prodhuesi Lenovo."Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 6-Lidhur me këtë pretendim, eksperti sqaron se mbështetja në këtë rast i referohet prodhuesit të pajisjes me të gjithë zgjidhjen e përfshirë. Sipas informatave në broshura dhe në faqen zyrtare të prodhuesit, Lenovo ofron mbështetje duke integruar softuerin VMware me pajisjet e tyre, për çka edhe ofron zgjidhjet/shërbimet e mbështetjes drejtpërdrejtë për VMware. Në autorizimin e prodhuesit ndër të tjera shënohet: "Virtuo O.P. is authorized to resell and service Lenovo HCI solution including VMware and all components that are part of HCI solution.". Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.*

Lidhur me pretendimin e shtatë ankimor: "*OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, përkatësisht kërkesën me numër rendor 2.Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 7AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, ka vendosur kërkesën me numër rendor 2 " Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të disponoj me së paku dy ekspert të certifikuar në infrastrukturën e ofruar HCI, apo infrastrukturës virtualizuese, të cilët duhet të kenë përvojë pune minimumi 3 vite, të kenë të paktën 1 projekt te realizuar nga fusha e lartë cekur." Dëshmitë e kërkuara dokumentare të kërkuara janë: " a. Certifikate përkatëse, (kopje e noterizuar nga origjinali ose linkun për verifikim); b.Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(kopje); d.Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara – (kopje); e.CV-në."OE i rekomanduar në ofertën e tij ka dorëzuar listën e inxhinierëve të caktuar për të zbatuar projektin, ku për lidhur me kërkesën e sipërpërmendur janë caktuar personat: Glauk Hoxha dhe Arber Lutolli.Për z.Arber Lutolli është dorëzuar certifikata e VMware Certified Professional Data Center Virtualization 2020, e cila mban datën 09.10.2020 dhe id e kandidatit VMW-02352072I-02362881.Për z.Arber Lutolli është dorëzuar certifikata e VMware VMware Certified Professional 6 Data Center Virtualization e*

cila mban datën 23.02.2017 dhe id e kandidatit VMW-00117936O-00094543.Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 7-Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti sqaron se AK kishte përcaktuar që OE duhet të dorëzojnë certifikatën e noterizuar ose linkun për verifikim. Certifikatat e dorëzuara nuk ishin të noterizuara e as linqet për verifikim. Megjithatë sipas të dhënave të certifikatave të dorëzuara AK ka mundur ta bëjë verifikimin e tyre përmes platformës Creadly e cila mundëson verifikimin e një certifikate të lëshuar nga Vmware. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e tetë ankimor: "*OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, përkatësisht kërkesën me numër rendor 3.Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 8AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, ka vendosur kërkesën me numër rendor 3 " Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të disponoj me së paku një ekspert të certifikuar të nivelit profesional CCNP ose ekuivalent, i cili duhet të kenë përvojë pune minimumi 3 vite, të kenë të paktën 1 projekt të realizuar nga fusha e lartë cekur." Dëshmitë e kërkuara dokumentare të kërkuara janë: " a. Certifikate përkatëse, (kopje e noterizuar nga origjinali ose linkun për verifikim); b.Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c.Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(kopje); d.Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara – (kopje); e.CV-në."OE i rekomanduar në ofertën e tij ka dorëzuar listën e inxhinierëve të caktuar për të zbatuar projektin, ku për lidhur me kërkesën e sipërpërmendur është caktuar z.Bartosz Strzepek. Për të njejtin OE si dëshmi të angazhimi ka dorëzuar Draft kontratë në të cilën nuk ceket se është e dedikuar për këtë projekt.Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 8-Sipas sqarimeve të sipërpërmendura, OE i rekomanduar ka dorëzuar kontratën me z.Bartosz Strzepek në të cilën nuk ceket emri i projektit/aktivitetit mirëpo draft kontrata ka të gjitha elementet tjera, ku përmendet se i njëjti do të angazhohet në instalimin, vendosjen, konfigurimin dhe mbështetjen e ToR Switch Juniper. Si dhe tek koha e angazhimit potencohet se i njëjti do të angazhohet në momentin e nënshkrimit të kontratës. Andaj, përkundër që në kontratë nuk ceket titulli i aktivitetit të prokurimit, e njëjta i përmban të gjitha elementet që dëshmon angazhimin dhe disponueshmerinë e ekspertit për përmbushjen e shërbimeve që kërkohen. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor është i pabazuar.*

Lidhur me pretendimin e nëntë ankimor: "*OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, përkatësisht kërkesën me numër rendor 4.Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 9AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, ka vendosur kërkesën me numër rendor 4 "Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të disponoj me së paku një ekspert të certifikuar nga prodhuesi për Load balancer zgjidhjen, i cili duhet të kenë përvojë pune minimumi 3 vite, të kenë të paktën 1 projekt te realizuar nga fusha e lartë cekur." Dëshmitë e kërkuara dokumentare të kërkuara janë: " a. Certifikate përkatëse, (kopje e noterizuar nga origjinali ose linkun për verifikim); b. Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(kopje); d. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara – (kopje); e.CV-në."OE i rekomanduar në ofertën e tij ka dorëzuar listën e inxhinierëve të caktuar për të zbatuar projektin, ku për lidhur me kërkesën e sipërpërmendur është caktuar z.Shkumbin Loku. Për të njejtin OE si dëshmi të angazhimi ka dorëzuar dokumentin me përmbajtjen si vijon: "Certifikatë e akreditimit, dhënë Shkumbin Lokut pas përfundimit me sukses të programit të*

trajnimit të inxhinierëve të certifikuar Load Balancer"Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 9-Lidhur me këtë pretendim, eksperti sqaron se kërkesa e AK-së është për ekspert të certifikuar nga prodhuesi për Load balancer zgjidhje. OE i rekomanduar ka dorëzuar dëshminë-certifikatë e akreditimit për përfundim me sukses të programit të trajnimit të inxhinierëve të certifikuar Load Balancer. Kërkesa nuk ka përcaktim specifik në kohëzgjatje apo elemente tjera të certifikimeve industriale në fushën e TI-së. Duke qenë kështu OE i rekomanduar ka dorëzuar dëshminë që përmbush kërkesën e AK-së, andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dhjetë ankimor: *"OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, përkatësisht kërkesën me numër rendor 5.Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 10AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, ka vendosur kërkesën me numër rendor 5 "Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të disponoj me së paku një ekspert për platformat serverike të ofruar, i cili duhet të kenë përvojë pune minimumi 3 vite, të kenë të paktën 1 projekt te realizuar nga fusha e lartë cekur". Dëshmitë e kërkuara dokumentare të kërkuara janë: " a. Certifikate përkatëse, (kopje e noterizuar nga origjinali ose linkun për verifikim); b. Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(kopje); d. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara - (kopje); e.CV-në."OE i rekomanduar në ofertën e tij ka dorëzuar listën e inxhinierëve të caktuar për të zbatuar projektin, ku për lidhur me kërkesën e sipërpërmendur është caktuar z. Norik Hoxha. Për të njejtin OE si dëshmi të angazhimi ka dorëzuar dokumentin me përmbajtjen si vijon: Lenovo Certified Norik Glauk Hoxha has Lenovo Certified Data Center Technical Sales Professional që në shqip i bie "Profesionist teknik i shitjeve i certifikuar nga Lenovo".Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK lidhur me këtë pretendim ka dhënë arsyetimin si vijon: "Pretendimi për 5.4 Kërkesa 5 nga FDT: Për këtë pozicion (ekspert për platformat serverike te ofruar) OE i propozuar, për këtë pozicion ka dorëzuar dokumentet për punëtorin Norik Hoxha, për te cilin ka bashkëngjitur certifikatën e arritur ne qershor te vitit 2024: Me ane te se cilës certifikate lere me qe nuk dëshmohet përvoja e punës 3 vjeçare ne platformat serverike e personit ne fjale, por e njëjta nuk ka asgjë te beje me realizimin dhe implementimin e projekteve te kësaj natyre. Ky pretendim nuk qëndron sepse Tenderuesi i shpallur fitues, për këtë kërkesë ka dorëzuar dëshmi dokumentacionin e nevojshëm si është kërkuar ne Dosje te tenderit, për te nijetin ka dorëzuar edhe dëshmi për përvojën e punës minimumi 3 vite. Nuk është kërkuar përvoja e punës pas diplomimi apo certifikimi, andaj pretendimi është i pabazuar. Kurse te përshkrimi i certifikatës, komisioni vlerësues ka vërtetuar se certifikimi me këtë certifikatë për veç tjerash eksperti merr njohuri dhe përgatitet edhe për implementimin e platformës serverike lenovo, me te cilën kane ofertuar."Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 10 Në lidhje me këtë pretendim eksperti sqaron se kërkesat për aftësitë teknike dhe/ose profesionale, përkatësisht kualifikimet shkollore dhe profesional të personelit, përcaktohen për tu siguruar AK se tenderuesit kanë kapacitetet njerëzore me kompetencë për implementimin (instalimet, konfigurimet dhe mirëmbajtjen) e pajisjeve në platformën që ofertohet nga OE. Më tej në ndërlidhje me pjesën e përvojës ku kërkohet përvojë në zbatimin e së paku një projekti nga kjo fushë, është qartë se bëhet fjalë për ekspertë në implementim të këtij aktiviteti që është kompleks dhe me rëndësi për institucionin. Ky certifikim sipas informatave nga prodhuesi (linku) e aftëson individin si një profesionist të aftë për të analizuar, prezantuar dhe shitur zgjidhje teknologjike të avancuara për qendrat e të dhënave, duke u fokusuar në nevojat specifike të klientëve të biznesit. Në anën tjetër AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim tek kjo pikë ka dhënë*

arsyetimin "komisioni vlerësues ka vërtetuar se certifikimi me këtë certifikatë për veç tjerash eksperti merr njohuri dhe përgatitet edhe për implementimin e platformës serverike lenovo, me te cilën kane ofertuar", i cili bie në kundërshtim me informatat e prodhuesit lidhur me këtë certifikim, për faktin se në broshurën e certifikimit askund nuk përmendet që personi që merr këtë certifikim merr njohuri për implementimin e platformës serverike Lenovo.Rrjedhimisht, dëshmia e dorëzuar nuk përmbush kërkesën e përcaktuar nga AK, për ekspert për platformat serverike të ofruara. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.

Lidhur me pretendimin e njembëdhjetë ankimor: "*OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, përkatësisht kërkesën me numër rendor 7.Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 11AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, ka vendosur kërkesën me numër rendor 7 "Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të sjellin katalogët ose broshura prej prodhuesit për pajisjet që oferton. Katalogët ose broshurat, duhet të jenë të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike për secilin lloje te pajisjes qe oferton. Nëse katalogu përfshin më shumë modele, ju duhet të nënvizoni (shënjoni) modelin me të cilin ofertoni;". Dëshmia e kërkuara dokumentare për këtë kërkesë është: "7. Katalogë ose broshura (kopje)"Sipas dosjes së tenderit, në këtë aktivitet përfshihen 6 lloje të pajisjeve: 1.Nodes HCI platform, 2.ToR Switches, 3.Load Balancers, 4.Rack Servers, 5.Rack Cabinets, 6.Hard Disk Drive (Hdd) Shredder.Tek pozicioni 1. Nodes HCI platform, OE ka dorëzuar broshurën Lenovo ThinkAgile VX Series, ku ka rrethuar produktin Lenovo ThinkAgile VX650 V3 Certified Node.Tek pozicioni 2. ToR Switches, OE ka dorëzuar broshurën e pajisjes Juniper QFX5120, në të cilën paraqiten informatat disa lloje të pajisjeve të këtij modeli, mirëpo nuk është nënvizuar modeli i përcaktuar. OE i rekomanduar ka dorëzuar deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara, ku evidentohet se për këtë pozicion oferton me produktin me numër: QFX5120-48Y-AFI2.Tek pozicioni 3. Load Balancers, OE ka dorëzuar broshurën e pajisjes Loadbalancer Enterprise Flex, ku janë paraqitë specifikimet dhe funksionet.Tek pozicioni 4. Rack Servers OE ka dorëzuar broshurën e produktit Lenovo SR650 V3, në të cilën paraqiten specifikimet teknike të produktit të ofertuar.Tek pozicioni 5. Rack Cabinets, OE ka dorëzuar broshurën e produktit Lenovo 42U 1200mm Deep Racks, në të cilën paraqiten dy modele. OE i rekomanduar ka dorëzuar deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara, ku evidentohet se për pozicionin 5.Rack Cabinets, oferton me produktin Rack 42U 1200mm Deep Static Rack (PN: 9361RC4). Rrjedhimisht është përcaktuar modeli i ofertuar në këtë pozicion.Tek pozicioni 6. Hard Disk Drive (Hdd) Shredder – OE ka dorëzuar broshurën e pajisjes KOBRA HDD ku paraqiten specifikimet teknike të kërkuara.Mendimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 11-Lidhur me këtë pretendimi, sipas sqarimeve të mësipërme, OE i rekomanduar për pozicionet 1, 3, 4 dhe 6 ka dorëzuar broshurat e produkteve në të cilat identifikohet pajisja e ofertuar sipas broshurës. Ndërsa për pozicionet 2 dhe 5 broshurat e dorëzuara kanë me shumë se një model ku në broshurë nuk është nënvizuar modeli i pajisjes që ofertohet. Megjithatë në deklaratën e dorëzuar nga OE përcaktohet modeli përmes kodeve të prodhuesve përkatës të cilat në ndërlidhje me broshurën, identifikojnë modelin e ofertuar, përkundër që jo të gjitha specifikimet teknike janë prezantuar në broshura. Andaj pretendimi ankimor është i pabazuar."*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe vleresoi se duhet mbajtur seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24

te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues nuk ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin. Andaj, kjo senacë është mbajtur me dt. 23.12.2024, ku morën pjesë të gjitha palët në procedurë, përfshirë përfaqësuesin e AK, përfaqësuesin e OE dhe ekspertet shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktuees gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe sqarimeve te dhena ne seancen degjimore dhe të gjitha provave që janë dorezuar nga palët procedurale.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore te parashtruara nga OE ankues kunder eliminimit te tij nuk i ka falur besimin konstatimeve të ekspertit shqyrtues, për te cilat jep konstatimet si ne vazhdim.

PSH Lidhur me pretendimin e parë ankimor te parashtruara nga OE ankues i cili pretendon se nuk qëndron arsyeja e eliminimit lidhur me kërkesën numër 4 të kapacitetit teknik dhe profesional, PSH konstaton se AK ka vendosur kërkesën si vijon: “4. Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të disponoj me së paku një ekspert të certifikuar nga prodhuesi për Load balancer zgjidhjen, i cili duhet të kenë përvojë pune minimumi 3 vite, të kenë të paktën 1 projekt te realizuar nga fusha e lartë cekur., PSH konstaton se lidhur me këtë kërkesë OE- te pjesemarreshe ne kete aktivitet të dorëzojnë dëshmitë si vijon: “1.a.Certifikate përkatëse, (kopje e noterizuar nga origjinali ose linkun për verifikim); b.Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c.Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(kopje);d.Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara – (kopje); e.CV-në.” per te cilen kerkese PSH konfirmon se OE ankues në oferten e tij ka dorëzuar si Ekspert z.A.A, PSH meqenëse qëllimi i ketij aktiviteti të prokurimit është me natyre specifike lidhur me kete pretendim ankimor i fal besimin pergjigjes se dhene nga AK, e cila ne seancen degjimore e konfirmon se referencat e OE ankues te cilat jane dorezuar si deshmi lidhur me pervojen e punes

se ekspertit ne fjale nuk e plotesojne kerkesen e parashtruar ne DTte pakten e nje projekti te realizuar nga fusha e lartecekur, rrjedhimisht PSH konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar.

PSH Lidhur me pretendimin e dytë ankimor te parashtruara nga OE ankues i cili pretendon se nuk qëndron arsyeja e eliminimit lidhur ekspertin për platformat serverike të ofruar , PSH konfirmon se kerkesa e parashtruar ne DT nga AK "5. Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të disponoj me së paku një ekspert për platformat serverike të ofruar, i cili duhet të kenë përvojë pune minimumi 3 vite, të kenë të paktën 1 projekt te realizuar nga fusha e lartë cekur.", po ashtu si deshmi lidhur me këtë kërkesë është kërkuar nga ofertuesit të dorëzojnë 5.a.Certifikate përkatëse, (kopje e noterizuar nga origjinali ose linkun për verifikim); b. Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(kopje); d. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara – (kopje); e.CV-në.", lidhur me kete kerkese bazuar ne dokumentacionin e dorezuar se bashku me oferten OE ankues ka dorëzuar si Ekspert z.A. L.. si dhe CV e z.A. L. , PSH gjate sqarimit te ketij pretendimi ankimor meqenese qellimi i ketij aktiviteti te prokurimit eshte natyre specifike besimin i fal pergjigjes se dhene nga AK , sepse AK ka kerkuar qe OE pjesemarresit deshmine ta deshmojne Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar dhe ose Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara e qe ne rastin konkrete OE ankues ka dorezuar per ekspertin ne fjale Reference e dates 14.08.2024 ne te cilen sipas AK -se jane realizuar sherbime dhe nuk ka asnje projekt te natyres se ngjashme per poziten nje ekspert per platformat soerverike te ofruar, bazuar ne pergjigjen e dhene nga AK dokumenteve te dorezuara nga OE ankues PSH vjen ne perfundim se pretendimi ankimor i parashtruar nga OE ankues eshte i pabazuar.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet ankimor te parashtruara nga OE ankues sa i perkete OE te rekomanduar i ka falur pjeserisht besimin raportit te ekspertit te 3,4,5,6,7,8,9,11 ndersa pergjigjeve tjera te dhena ne raport lidhur me OE te rekomanduar PSH nuk i ka falur besimin .

PSH lidhur me pretendimin e tretë ankimor OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson specifikimet teknike për disqet të përcaktuara në dosjen e tenderit në pozicionin AK në dosjen e tenderit, përkatësisht tek Aneksi 1-Specifikimet Teknike të Detyrueshme, pika 3.3 Kërkesat teknike, pozicioni 1, ndër të tjera ka përcaktuar specifikimin teknik si vijon: " The HCI should be proposed with 7.6TB NVMe for capacity tier per server node, with min 50TB per Node with min 7.68 NVMe Gen 5 per node. Appropriate RAID Controller must be supplied with Caching capabilities."lidhur me kete pretendim ankimor PSH konfirmon se AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka përcaktuar kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional si vijon: "7. Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të sjellin katalogët ose broshura prej prodhuesit për pajisjet që oferton. Katalogët ose broshurat, duhet të jenë të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike për secilin lloje te pajisjes qe oferton. Nëse katalogu përfshin më shumë modele, ju duhet të nënvizoni (shënjoni) modelin me të cilin ofertoni, ndesa si deshmi AK ka përcaktuar që OE-të duhet të dorëzojnësi vijon: "7. Katalogë ose broshura (kopje).". Lidhur me kete kerkese PSH konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar broshurën e prodhuesit Lenovo për serinë e produktit ThinkAgile VX Series, PSH lidhur me kete pretendim ankimor i fal besimin pergjigjes se dhene nga AK e cila e siguron panelin edhe ne seancen e mbajtur të cilen e perfaqesonte edhe zt. B.Iballi si Administrator i Sistemit të ASHI-së me theks te veqante duke e cilesuar se OE i rekomanduar per kontrate ka

ofruar garancionin e Lenovos ne MAF te cekur, deklaraten nenbetim dhe sigurimin e ekzekutimit dhe nisur nga parimi qe vet AK shte i obliguar te siguroje qe te gjitha keto sherbime janë nën përgjegjësinë e tyre dhe mbi te gjitha edhe pse eksperti shqyrtues dhe teknik kane propozuar qe AK te kerkoj sqarime shtese PSH thekson se neni 72 i LPP-se per sqarime shtese nuk ka karakter detyrues dhe rrjedhimisht AK mbanë pergjegjesine për kete projekt pasi qe edhe vet është implementuese e ketij projekti.

PSH lidhur me pretendimin e pestë ankimor OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson specifikimet teknike përkatësisht shërbimi i mbështetjes i ofruar për HCI nodes.Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor ,në dosjen e tenderit, përkatësisht Aneksin 1 të dosjes së tenderit, tek pozicioni 1, AK ndër të tjera ka përcaktuar specifikimin si vijon: "3 years Direct Vendor Support with 24X7x365 coverage and access to vendor support. (shqip: 3 vjet mbështetje e drejtpërdrejtë e shitësit me mbulim 24X7x365 dhe qasje në mbështetjen e shitësit) PSH lidhur me kete pretendim ankimor nuk pajtohet me pergjigjen e dhene ne raportin e ekspertizes pasi qe sipas raportit eksperti ka rekomanduar qe AK duhet te kerkoj sqarime shtese, mirepo PSH nisur nga fakti se dispozita ligjore e nenit 72 te LPP-se nuk ka karakter detyrues andaj per te njejten pretendim ia fal besimin pergjigjes se dhene te AK gjate seances degjimore t dhe rrjedhimisht AK mbane pergjegjesine per kete pasi qe edhe vet eshte implementuese e ketij projekti.

PSH lidhur me pretendimin e dhjetë ankimor OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, përkatësisht kërkesën me numër rendor 10 AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2, ka vendosur kërkesën me numër rendor 5 "Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të disponoj me së paku një ekspert për platformat serverike të ofruar, i cili duhet të kenë përvojë pune minimumi 3 vite, të kenë të paktën 1 projekt te realizuar nga fusha e lartë cekur". PSH vlereson se Dëshmitë e kërkuara dokumentare per kete kerkese janë: " a. Certifikate përkatëse, (kopje e noterizuar nga origjinali ose linkun për verifikim); b. Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje); c. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(kopje); d. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara - (kopje); e.CV-në.PSH lidhur me kete pretendim ankimor i fal besimin pergjigjes se dhene AK ne seancen degjimore e cila ka arsyetuar se OE i rekomanduar per kontrate ka dorezuar deshmi - dokumentacion te nevojshem per ekspert per platforamt serverike te ofruar per zt. N.H., sipas AK OE i rekomanduar per kontrate ka dorezuar ekspert per paltformat serverike dhe jo te implementimit, andaj nisur nga fakti sikurse ne pretendimin ankimor si me larte, PSH konsideron se eshte pergjegjesi e AK -se pasi qe AK eshte implementuese e ketij projekti.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Krijimi i Qendrës së Rimëkëmbjes" me numër të prokurimit 214-24-6184-1-1-1.Në këtë drejtim, duhet të theksohet se autoriteti kontraktues e gëzon autonominë e plotë për të ekzaminuar, krahasuar edhe vlerësuar të gjitha ofertat e pranuara në një aktivitet të prokurimit. Duke qenë se në rastin konkret AK ka vlerësuar dokumentet në mënyrën e elaboruar si më sipër, nuk ekziston bazë e mjaftueshme as për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit si të tille.

Paneli Shqyrtues gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit si dhe pas mbajtjes se senaces degjimore i ka falur besimin përgjigjes së autoritetit kontraktues. Kjo pasi që këto përgjigje të AK konfirmohen jo vetëm përmes vendimit te pergjigjes se kerkeses per rishqyrtim si dhe pergjigjes se dhene ne raportin e ekspertit shqyrtues por edhe përmes dosjes së tenderit si dhe ofertës së operatoreve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit. Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se "*Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen,* ***duke përfshirë interesin publik***". Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit si dhe mbrojtjen e buxhetit te shtetit per faktin kur kemi parasysh se OE i rekomanduar per kontrate ka nje diference ne çmim prej rreth 234,011.00 € me te lire se OE ankues.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues,seances se mbajtur degjimore ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet vetëm si pjesërisht e bazuar mirëpo Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme i datës 27.09.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i Qendrës së Rimëkëmbjes" me numër të prokurimit 214-24-6184-1-1-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 1 , nenin 6 , nenin 7, nenin 8, nenin 9, nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës, po ashtu vlen te theksohet se AK ne kete rast gjate seances se mbajtur me nje vendosmeri te fuqishme konfirmoj se OE i rekomanduar perveq se i ploteson te gjitha nevojat e percaktuara ku perfshihet i gjithe rrjeti qeveritar perfshire edhe E-Kosova, po i njejti konsiston edhe me nje çmim te ulët se OE ankues permbi 234,011.00 € ku njekohesisht kursehet konisderueshsem edhe buxheti i konsiliduar i RKS-se.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **Infosoft Systems SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: